



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Viti: 2017 – Numri: 90

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 27 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 48/2017, datë 20.4.2017	Për caktimin e numrit të mandateve për çdo zonë zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017..... 5177
Vendim i Kuvendit nr. 49/2017, datë 20.4.2017	Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj..... 5177
Rezolutë e Kuvendit datë 20.4.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016..... 5182
Rezolutë e Kuvendit datë 20.4.2017	Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri për vitin 2016..... 5183
Dekret i Presidentit nr. 10152, datë 24.4.2017	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 5184
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 21.4.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 61, datë 2.6.2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjetisë në Republikën e Shqipërisë” 5184
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatmir Bruzja..... 5195
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasës Lumturi Boka..... 5195



VENDIM
Nr. 48/2017

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË
MANDATEVE PËR ÇDO ZONË
ZGJEDHORE TË ZGJEDHJEVE
PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË
TË VITIT 2017**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, dhe të nenit 76, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në përfundim të procedurave të miratimit të numrit të mandateve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 173, prot., datë 3.12.2016,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Caktohet numri i mandateve për çdo zonë zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017 si më poshtë:

Zona zgjedhore qarku Berat	7 (shtatë) mandate
Zona zgjedhore qarku Dibër	6 (gjashtë) mandate
Zona zgjedhore qarku Durrës	14 (katërbëdhjetë) mandate
Zona zgjedhore qarku Elbasan	14 (katërbëdhjetë) mandate
Zona zgjedhore qarku Fier	16 (gjashtëmbëdhjetë) mandate
Zona zgjedhore qarku Gjirokastër	5 (pesë) mandate
Zona zgjedhore qarku Korçë	11 (njëmbëdhjetë) mandate
Zona zgjedhore qarku Kukës	3 (tre) mandate
Zona zgjedhore qarku Lezhë	7 (shtatë) mandate
Zona zgjedhore qarku Shkodër	11 (njëmbëdhjetë) mandate
Zona zgjedhore qarku Tiranë	34 (tridhjetë e katër) mandate
Zona zgjedhore qarku Vlorë	12 (dymbëdhjetë) mandate

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 20.4.2017

VENDIM
Nr. 49/2017

**PËR KRIJIMIN E MEKANIZMIT PËR
MONITORIMIN SISTEMATIK TË
NDJEKJES DHE ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE TË
INSTITUCIONEVE TË PAVARURA
KUSHTETUESE DHE ATYRE TË
KRIJUARA ME LIGJ**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 80, të Kushtetutës, të neneve 18, 55, 88, 102, 103, 120 dhe 121, të Rregullores së Kuvendit, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe të ligjeve organike të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, sipas lidhjeve bashkëlidhur.

II. Institucionet e pavarura, organet dhe institucionet e administratës shtetërore dhe Kuvendi bashkëpunojnë për ndjekjen dhe zbatimin në vazhdimësi të këtij mekanizmi.

III. Bashkërendimi dhe realizimi i masave të përcaktuara në këtë mekanizëm i nënshtrohen përditësimit, sipas prioriteteve dhe problematikave të institucioneve, të përcaktuara në pikën II, të këtij vendimi, rast pas rasti.

IV. Ngarkohen organet e Kuvendit dhe shërbimet e Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 20.4.2017



Lidhja 1: Veprimet e Kuvendit/organeve të Kuvendit

1. Takim midis Kryetarit të Kuvendit/kryetarëve/kryesive të komisioneve dhe titullarëve të institucioneve të pavarura për çështjet e institucioneve të pavarura.	Afati Me fillimin e çdo sesioni të vjeshtës	Konkluzionet/Masat Mesazh bashkëpunimi dhe vendosja e piketave kryesore për vijimësi të bashkëpunimit dhe raportimit, si dhe për hartimin e planit vjetor të punës për vitin pasardhës dhe adresimin e tij Kuvendit.
2. Të bashkëkordinohet kalendari i krijuar nga komisionet parlamentare për kontrollin parlamentar ndaj Qeverisë me atë të kontrollit për çështje të institucioneve të pavarura.	Një herë në vit të gjendet e përshtatur me problematikat e raportuara pas ezaurimit të raporteve vjetore dhe pas çështjeve që kanë dalë nga takimi i përmendur në pikën 1.	<ul style="list-style-type: none"> - Komisionet hartojnë kalendarin e diskutimit/ndjekjes së zhvillimeve/moszhvillimeve të punës së institucioneve të pavarura me argumentet përkatëse. - Komisionet shohin mundësinë e vendosjes së një plani tematik për një çështje specifike të rëndësishme prioritare, rast pas rasti, në varësi të çështjes së ndodhur. - Komisionet të përfshihen në hartimin e kalendarit specifik për dëgjesa apo info me shkrim për gjetjet dhe masat për progres-raportin e vitit, për çdo institucion dhe të prezantohet nga institucionet plani i veprimit konkret për zbatimin e masave që rekomandon ky progresraport. - Po në këtë kalendar dëgjesash, të raportohet nga institucionet edhe në kuadër të zbatimit të rekomandimeve ndërkombëtare, të përfshihet edhe një shtyllë tjetër e identifikimit për zbatimin e masave lidhur me instrumentet e tjera ndërkombëtare ku Shqipëria është anëtare dhe nga ku dalin rekomandime specifike për t'u përmbushur nga aktorët më kryesorë në vend, siç janë Ekzekutivi, Legjislativi, Gjyqësori, por edhe institucionet e tjera të pavarura. (rek. ILDKPKI p.sh. për raportimin e masave, sipas rekomandimeve të GRECO-s, instrument i Këshillit të Europës, ku kërkohet në mënyrë të koordinuar bashkëpunimi tripalësh: Qeveri-Kuvend-Inst. Pav.
3. Të përcaktohen qartë përgjegjësitë ndërmjet komisioneve të Kuvendit për mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre.	Periodikisht gjatë gjithë vitit	Të bashkëpunohet më ngushtë me stafin e komisioneve parlamentare që të sjellin në vëmendje të kryesisë së komisionit çështjet e ndryshme të referuara/adresuara nga institucionet e pavarura së bashku me materialet mbështetëse të SHMI për rastin konkret të adresuar, për vëmendje të komisioneve përgjegjëse, por dhe komisioneve të tjera që mund të prekin një fushë që ato mbulojnë dhe orientimin e tyre për vijim të përgjigjeve apo hapave të mundshëm parlamentarë. (Ka mjaft institucione që, për shkak të objektit të gjerë të ligjit, mund të raportojnë edhe në komisione të tjera të fushave që përfshin ligji i posaçëm, si KMD: përcaktim ligjor në disa komisione të Kuvendit apo PP, ILDKPKI etj.)
4. Për çështje të veçanta sensitive për të drejtat e njeriut, si dhe për raste flagrante që rezultojnë në mënyrë të vazhdueshme me moskthim përgjigjesh apo moszbatim rekomandimesh nga	Gjatë gjithë vitit	Plan veprimi nga nënkomisionet parlamentare për kalendar dëgjesash, ku të grumbullohen disa çështje, sipas prioriteteve dhe emergjencave në raport me interesin e publikut. <i>Follow up</i> i këtij aktiviteti, me afate të mirëpërcaktura kur dhe si përcillet çështja në vijim parlamentar.



administrata publike, Avokati i Popullit përveç Kryetarit të Kuvendit, t'i drejtohet konkretisht dhe njëkohësisht nënkomisioneve parlamentare të atashuara pranë komisioneve përgjegjëse, si dhe komisioneve përgjegjëse.		
5. Të zbatohet përcaktimi i Rregullores së Kuvendit për mbajtjen e raportit vjetor në seancë plenare.	Sipas përcaktimeve të Rregullores në kohën para votimit të rezolutës së vlerësimit të punës së institucionit në seancë plenare.	Zbatimi i nenit 103 të Rregullores së Kuvendit/pikat 3 dhe 4 të tij.
6. Në raportin vjetor të KLSH-së, komisioni përgjegjës të marrë paraprkishtë raportin e Qeverisë për gjetjet e KLSH-së dhe statusi i zbatimit/moszbatimit të tyre/organ tjetër ndoshta nga PP për pretendimet për ecurinë e kallëzimeve penale të referuara. Mund të kryhet edhe nga komisione të tjera parlamentare për ILDKPKI-në, Avokatin e Popullit dhe inst. të tjera në varësi të çështjeve që i prekin me këto organe.	Gjatë raportimit vjetor, përpara dëgjësës	Të grumbullohet info përkatëse nga Ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin p.sh.

Lidhja 2: Masat e Qeverisë/ Ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

1. Ministria për Marrëdhëniet me Parlamentin rekomandohet të propozojë për hartimin e një qarkoreje ose VKM-je institucioneve të ekzekutivit për statusin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.	Afati: raportim/dëgjësë në komision një herë në vit (pas mbylljes së raportimeve vjetore të institucionit, por para draftimit të rezolutës për votim në seancë plenare)	E vlefshme për raportimin e ardhshëm të çdo institucioni të pavarur në Kuvend. <i>Road-Map</i> me plan veprimi të zbatimit të masave nga institucionet e administratës shtetërore të rekomanduara nga institucionet e pavarura. Mund të hartohet një VKM për detyrueshmërinë e zbatimit nga institucionet shtetërore për rekomandimet kryesisht të Avokatit të Popullit dhe KLSH-së (për kronologji nga praktika e mëparshme, kanë ekzistuar VKM për zbatimin e rekomandimeve për secilën prej këtyre dy institucioneve).
Një herë në vit (rekomandohet gjashtëmujori i dytë) Qeveria duhet të raportojë në Kuvend mbi gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.	një dëgjësë në fundvitin kalendarik për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të tyre dhe arsyet e moszbatimit të rekomandimeve të Av. të Popullit për raportimin një herë në vit të Ministrisë për Marrëdhëniet me Parlamentin në fund të vitit, me fokus zbatimin e rek. të Av. të Pop. Në diskrecion të organizimit të vetë komisioneve dhe nënkomisioneve, mund të caktohet një seancë e posaçme vetëm për raportimin e çështjeve të Av. të Pop. dhe KLSH-së. Në fund të vitit, pasi është raportuar ecuria e 6-mujorit të parë, Kuvendi	Mundësia për ngritjen e një sistemi <i>online</i> mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Sistemi të jetë një <i>software</i> , i cili mundëson aksesin në kohë reale dhe komunikimin ndërinstitucional midis institucioneve të pavarura, Parlamentit dhe Ministrisë për Marrëdhëniet me Parlamentin. Financimi i sistemit nga vetë ministria ose me donatorë.



	(organet e Kuvendit/komisionet) me praninë e Av. të Pop. dhe ministrisë mund të organizojnë një seancë dëgjimore lidhur me statusin e zbatimit të rekomandimeve. Ndërsa për int. e tjera mund të jetë një seancë e vetme raportimi nga Ministria e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.	
2. Ministria e Financave të raportojë për zbatimin e planit të saj të veprimit specifikisht lidhur me KLSH-në (rekomandimet e KLSH-së dhe masat e saj për zbatimin e buxhetit, si dhe raportet e auditimit të KLSH-së).	Fillim 2017: Sipas Rregullores dhe një kalendari të hartuar nga vetë Komisioni për Ekonominë dhe Financat për kontroll parlamentar nga Komisioni për Ekonominë dhe Financat.	Krijimi në fillim të 2017-s i një nënkomisioni parlamentar për çështjet e KLSH-së (është aprovuar propozimi i vetë Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat gjatë raportimit vjetor të KLSH-së në korrik dhe shtator 2016 dhe dakordësuar nga ky komision për t'u ngritur një nënkomision. Është finalizuar si masë e kërkuar në rezolutën e votuar në seancë plenare për veprimtarinë e vitin 2015 për KLSH-në.
3. Qeveria të jetë e disponueshme për sigurim kapacitetesh administrative dhe financiare në kërkesat që bëjnë të argumentuara institucionet e pavarura gjatë buxhetimit të tyre.	Gjatë fazës së draftimit të projektbuxhetit të vitit pasardhës, por dhe gjatë rasteve kur ka buxhet të rishikuar në mes të vitit, ku të mos reduktohen fondet e këtyre institucioneve, të cilat mund të cenojnë prioritetet kryesore të tyre.	Koordinim më i ngushtë midis institucioneve të pavarura dhe Ministrisë së Financave, si dhe dijeni për çdo rast të këtyre diskutimeve edhe me komisionet respektive përgjegjëse dhe me Komisionin për Ekonominë dhe Financat.
4. Në rast të nevojës për adresime legislative, institucionet e pavarura t'i drejtohen dhe Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin si një ministër i cili ka akses për dhënie mendimi në çdo projektakt që i propozohet Qeverisë.	Në çdo kohë	Ministria bën veprimet e saj, sipas objektivit të veprimtarisë së saj, bazuar në aktet përkatëse nënligjore dhe informon Kuvendin, si dhe inst. e tjera si shtysë për iniciimin e propozimit konkret.

Lidhja 3: Masat dhe detyrat e shërbimeve të Kuvendit /Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura

1. SHMI/Shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm për info periodike lidhur me zbatimin e rek. të inst., por dhe me rekorde të tjera të ligjshmërisë së punës deri në përfundim të ankimeve gjyqësore për raste të procedurave të largimit nga shërbimi civil, por dhe raste të tjera të lidhura me aktivitetin institucional.	2017 dhe në vijim
2. Info specifike për kallëzimet penale dhe statusin e procedimeve penale dhe ecurisë gjyqësore të tyre. Analizë rrisht nga çdo institucion në aspekte të vendimmarrjes, kryesisht të politikës penale dhe gjyqësore.	Pjesë e analizës së raportit vjetor
3. SHMI/Shkresë të Sekretarit të Përgjithshëm për info periodike lidhur me zbatimin e rek. të inst., por dhe me rekorde të tjera të ligjshmërisë së punës deri në përfundim të ankimeve gjyqësore për raste të procedurave të largimit nga shërbimi civil, por dhe raste të tjera të lidhura me aktivitetin institucional.	2017 dhe në vijim
4. Info specifike për kallëzimet penale dhe statusin e procedimeve penale dhe ecurisë gjyqësore të tyre.	Pjesë e analizës së raportit vjetor



Analizë risku nga çdo institucion në aspekte të vendimmarrjes, kryesisht të politikës penale dhe gjyqësore.	
5. Dërgimi në fillim të çdo vitit të planit të veprimit të çdo institucioni dhe info për progresin çdo 6 muaj. Bazuar në planin e punës dhe objektivat, Kuvendi duhet të hartojë indikatorët e performancës, me anë të cilëve do të mbikëqyrte realizimin e planit të punës në afate të caktuara kohore dhe do të ndihmojë edhe gjatë fazës së raportimit vjetor apo ndonjë raportim tjetër të mundshëm gjatë vitit.	Janar 2018 (të shoqërohet edhe në raportimin vjetor statusi i implementimit tërësor të çdo pike të rezolutës së një vitit më parë nga Kuvendi që të jetë e gatshme për krahasimin dhe vlerësimin e performancës së punës. Modeli i KLSH-së, plan veprimi për detyrat e rezolutës së Kuvendit për vitin 2014 dhe 2015 i sapodërguar nga ky institucion, është një model shumë i mirë për t'u bërë dokument i përhershëm shoqëruar gjatë paraqitjes së raportit vjetor).
6. Elemente të unifikuara të materialit të raportit vjetor/standardizim i piketave të raportimit dhe çështjeve që duhen analizuar në nivel parlamentar. Detyrueshmëria e përfshirjes në raport vjetor të analizës financiare (audit i brendshëm dhe ose i jashtëm) dhe transparenca për përfitimet e fondeve jobuxhetore (projekte/fonde/donacione, si dhe raportim i përfshirë nga institucionet për nivelin e zbatimit të ligjit për shërbimin civil (nga vetë institucioni, ndërkohë që SHMI mban në konsideratë edhe raportet e mbikëqyrjes së KMSHC-së apo dhe info të tjera nga DAP-i aty ku ka informacion të vlefshëm).	Pjesë e raportimit vjetor, do të asistohet nga SHMI
7. Pjesë e veçantë e raportimeve vjetore në Kuvend duhet të jenë dhe ato për rekomandime, për numrin, cilësinë, nivelin, shkallën e zbatimit dhe ndjekjes për zbatim të tyre. Të shikohet mundësia e informimit të Kuvendit, posaçërisht për çështje të rekomandimeve, si shtojcë e kornizës së raportimit vjetor.	Pjesë përfshirëse në raportimin vjetor
8. Unifikim i formatit të tekstit të rezolutave, duke konkretizuar pjesën rekomanduese (<i>pa anashkaluar pjesët e tjera</i>).	SHMI, komisionet parlamentare
9. Shtim i analizës së SHMI për buletinet tremujore periodike të KLSH-së dhe njohja e tyre deputetëve me një përmbledhje.	Angazhim i shtuar i stafit të SHMI për të ofruar këtë info Komisionit për Ekonominë dhe Financat/ose nënkomisionit që pritet të ngrihet pranë këtij komisioni.
10. Zbatimi i ligjit të dekriminalizimit	SHMI si strukturë përgjegjëse e ngritur me urdhër të Kryetarit të Kuvendit për funksionarët dhe kandidatët për titullarë të institucioneve të pavarura që zgjidhen nga Kuvendi.
11. Ndërtimi i një metodike veprimesh dhe bashkëkoordinimi me institucionet e pavarura dhe me shërbimet e tjera të Kuvendit për ndjekjen e propozimeve legjislative të adresuara nga institucionet e pavarura në organet e ekzekutivit për ndërmarrjen e nismës nga KM apo dhe në Kuvend për nismë nga brenda.	Në vijimësi gjatë vitit 2017 dhe në vijim të vitit vijues Informim dhe ndjekje nga SHMI për çdo rast të propozimit për ndërhyrje ligjore në legjislacion, fazat e ndjekura, argumentimi ligjor për ndërhyrje dhe kohët e moskonsiderimit të tij nga organet kompetente (Ministria përgjegjëse/Ministria e Drejtësisë, KM). Masat për sjellje vëmendje deputetëve për marrjen në konsideratë të tyre në raste të dështimit/vonesës së marrjes në konsideratë të propozimit ligjor nga ministritë. <i>Libet e hapur për diskutim mënyra dhe metodika se si do të nxitet (SHMI në bashkëpunim me komisionet etj.)</i>
12. Raport i veçantë i SHMI për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe publikimi i tij.	Në fund të vitit si botim i veçantë i vetë SHMI, përveç atij vjetor të shërbimit në kuadër të raportimit tërësor të shërbimeve të administratës së Kuvendit.



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2016

Pas shqyrtimit të raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë e vitit 2016 dhe vlerësimit të çështjeve të ngritura në raport në lidhje me:

- Organizimin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të bashkive Dibër dhe Kolonjë;

- Shqetësimet e lidhura me raportet financiare të partive politike dhe auditimeve të fondeve të fushatave, që vijnë si pasojë e mungesës së rregullimeve ligjore në legjislacionin që rregullon veprimtarinë e partive politike;

- Problematikat e hasura nga KQZ-ja gjatë shqyrtimit të rasteve të lidhura me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, përfshirë mënyrën e zgjedhjes së tyre nga KQZ-ja;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se KQZ-ja gjatë vitit 2016:

- Ka realizuar në një pjesë të konsiderueshme kërkesat dhe detyrat e lëna nga Kuvendi, me rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015”;

- Ka monitoruar dhe zgjidhur në kohë problematikat e hasura gjatë proceseve të pjesshme zgjedhore për kryetar të bashkive Dibër dhe Kolonjë;

- Për herë të parë është përballur me trajtimin e çështjeve që kishin lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Me gjithë vështirësitë në zbatim, për shkak të paqartësive dhe boshllëqeve në ligj për sa i takon trajtimin të rasteve të ndryshme, KQZ-ja ka interpretuar dhe ka vendosur drejt, duke vlerësuar se individët që janë subjekt i këtij ligji duhet të plotësojnë e të nënshkruajnë një formular vetëdeklarimi, me anë të të cilit deklarojnë mosekzistencën e shkaqeve të parashikuara nga ky ligj dhe që përbëjnë ndalim për të kandiduar, për t’u zgjedhur ose emëruar. Qëllimi i ligjit nr. 138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike,

nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t’u zgjedhur, apo emëruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura në regjistrat publikë, të cilët janë regjistra zyrtarë e që nuk plotësohet me vetëdeklarim, por sipas procedurave të posaçme ligjore, apo të tjerë që kanë deklaruar të dhëna shtesë pas përfundimit të afatit të deklarimit.

Në këto kushte, duke konsideruar që viti në vazhdim është vit zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të fokusohet kryesisht në ato drejtime që kanë të bëjnë me funksionet unike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në një vit zgjedhor.

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fokusimin në këto drejtime:

- Duke konsideruar që viti 2017 është vit zgjedhor, në të cilin organizohen zgjedhjet parlamentare të radhës, rekomandohet angazhim maksimal i të gjitha njësive dhe strukturave të KQZ-së për organizimin e një procesi para dhe paszgjedhor me standarde të larta;

- Angazhimin maksimal në funksionet që kanë lidhje me procesin e dekriminalizimit dhe me zbatimin e ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, për sa i takon verifikimit të kandidatëve për zgjedhjet e përgjithshme, duke qenë ky një proces shumë i rëndësishëm në themel të cilësisë së Kuvendit të ardhshëm;

- Të përfundohet zhvillimi i moduleve/ programeve kompjuterike dhe të kryhet instalimi dhe testimi paraprak i tyre, për t’u përdorur në zgjedhjet e Kuvendit 2017.

- Të marrë masa për zbatimin të vendimit për “Miratimin e planit orientues të veprimeve”, në funksion të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017, duke konsideruar që Plani Orientues i Veprimeve është një kornizë udhëzuese për veprimet dhe aktet nënligjore, mbi të cilat do të mbështetet aktiviteti i mëtejshëm i KQZ-së.

- Në funksion të zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, në bashkëveprim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile,



- të referojë zbatimin e problematikave të vërejtura lidhur me listat e zgjedhësve; si dhe

- të shqyrtojë e të monitorojë masat e marra nga administrata e gjendjes civile.

- Është i rëndësishëm fillimi i një vlerësimi të plotë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në emigracion, në lidhje me hapat që duhen ndërmarrë dhe metodologjinë që duhet zbatuar, me synim lehtësimin dhe garantimin e së drejtës kushtetuese të tyre për të votuar, rekomandim ky që është dhënë edhe më parë me rezolutën e vitit 2015.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 20.4.2017

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, në vijim ISKK, si institucion publik i pavarur me rëndësi të veçantë për trajtimin e periudhës së regjimit komunist;

Rolin e ISKK-së në studimin me objektivitet të periudhës së regjimit komunist, analizimin dhe dokumentimin e krimeve të kryera nga organet e diktaturës komuniste, si dhe pasojat gjatë dhe pas periudhës së komunizmit;

Rolin studimor të ISKK-së në grumbullimin e të dhënave, dokumenteve dhe dëshmime, për hedhjen dritë mbi veprimtarinë e organeve dhe të strukturave të ish-Sigurimit së Shtetit, të formave të persekutimit dhe formave të rezistencës kundër tyre, si dhe të të gjitha veprimtarive që kanë çuar në dhunimin e të drejtave e të lirive themelore të njeriut në vitet e regjimit komunist;

Fillimin e zbatimit të marrëveshjes midis ISKK-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për informimin e nxënësve të shkollave të mesme të kryeqytetit, në lidhje me krimet dhe format e përndjekjes së qytetarëve gjatë diktaturës komuniste, luftës së klasave, biografisë, dëbim-internimeve etj.;

Rolin e ISKK-së në informimin e strukturave të posaçme të OKB-së, që trajtojnë çështje të kujtesës kolektive dhe të drejtave të njeriut, në lidhje me zbardhjen e së shkuarës komuniste në Shqipëri, dhe arritjet studimore në evidentimin e keqtrajtimit të grave dhe fëmijëve gjatë diktaturës, si dy kategoritë më të pambrojtura sociale;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2016 ISKK:

Ka kryer studime në lidhje me evidentimin e kushteve mizore të punës dhe trajtimit në burgje, veçanërisht në burgjet-miniera.

Ka kryer studime në lidhje me evidentimin e rezistencës brenda grupimeve me bindje të djathta dhe të majta, ndaj totalitarizmit të regjimit komunist; roli i perëndimit në këtë rezistencë.

Ka kryer kërkime mbi mekanizmat e paligjshëm të konfiskimit të pronës, gjatë periudhës së ish-regjimit komunist.

Ka filluar për herë të parë fushatën e informimit mbi krimet e ish-regjimit komunist në shkollat e mesme të kryeqytetit, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Ka informuar strukturat e posaçme të OKB-së, që trajtojnë çështje të kujtesës kolektive dhe të drejtave të njeriut, në lidhje me zbardhjen e së shkuarës komuniste në Shqipëri, evidentimin e rasteve të keqtrajtimit të grave dhe fëmijëve gjatë diktaturës, si dy kategoritë më të pambrojtura sociale.

Ka kryer analiza në lidhje me strategjinë e përdorur nga regjimi komunist për internimin masiv të mijëra familjeve politike gjatë periudhës 1945-1954.

Ka kryer studime në lidhje me trajtimin çnjerëzor dhe të paligjshëm të grave dhe fëmijëve në kampet e internimit me tela (1945-1954).

Ka kryer studime mbi proceset e ridënimeve brenda burgjeve dhe proceset e inskenuara gjyqësore.

Ka kryer studime në lidhje me mekanizmat e përgjimit të përdorur nga ish-Sigurimi i Shtetit, sidomos në fund të viteve 80;

Ka krijuar dhe pasuruar arkivin audiovizual, si dhe atë dokumentar, që do të shërbejë si bazë e rëndësishme informacioni për studiuesit.

Ka vijuar të mbështesë studimet shkencore rreth krimeve të komunizmit me doktorantë të huaj e shqiptarë pranë universiteteve të Europës e Amerikës, duke u afruar atyre dokumentet dhe



literaturën e nevojshme dhe konsulencën shkencore në këtë drejtim. Viti 2016 ka pasur një fluks studentësh që janë paraqitur për të shfrytëzuar arkivat dhe literaturën e institutit.

Mandatet e anëtarëve të Bordit të ISKK-së kanë përfunduar që më datë 22.7.2015. Gjatë vitit 2016 nuk ka nisur akoma procesi për propozimin e anëtarëve të rinj të Bordit të ISKK-së.

Kuvendi i Shqipërisë përgjatë vitit 2017 kërkon nga ISKK:

Angazhim në vazhdimësi në studimin dhe vlerësimin me objektivitet të natyrës së krimeve të ish-regjimit komunist në Shqipëri;

Analiza të thelluara në lidhje me mënyrën e ndërtimit, organizimit institucional dhe veprimtarinë e strukturave shtetërore, veçanërisht të organeve dhe të strukturave të ish-Sigurimit të Shtetit gjatë periudhës së regjimit komunist;

Identifikimin e akteve ligjore dhe nënligjore, sekrete dhe josekrete, të përgatitura apo të miratuara nga organet e autoritetet shtetërore dhe kushtetuese, të cilat kanë shërbyer si bazë e organizimit dhe e funksionimit të të gjithë aparatit të sistemit komunist;

Publikimin dhe përhapjen e materialeve të shkruara, si dhe organizimin ekspozitave, seminareve, konferencave e diskutimeve për krimet e komunizmit dhe pasojat e tij në Shqipëri;

Zbatimin në vazhdimësi të marrëveshjes me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për informimin e nxënësve të shkollave të mesme, lidhur me krimet dhe format e përndjekjes së qytetarëve gjatë diktaturës komuniste;

Kuvendi Shqipërisë duhet t'u kërkojë subjekteve që propozojnë anëtarët e Bordit të ISKK-së fillimin e procedurave përzgjedhëse dhe depozitimim e kandidaturave në Kuvendin e Shqipërisë;

Nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis ISKK-së dhe Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, lidhur me analizimin e strukturave të ish-Sigurimit të Shtetit gjatë periudhës së regjimit komunist;

Vazhdimin e procesit të sistemimit dhe katalogimit të kujtimeve të të dënuarve politikë, qoftë të atyre që u burgosën, edhe të atyre që u persekutuan në kampet e internimit;

Krijimin e një regjistri në formë elektronike, për përpunimin e të gjithë dokumentacionit për krimet e regjimit komunist në Shqipëri me akses publik ndaj qytetarëve;

Forcimin e bashkëpunimit me institucionet kërkimore, kulturore, arsimore dhe institucione të tjera për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, si dhe me institucionet homologe të huaja.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 20.4.2017

DEKRET

Nr. 10152, datë 24.4.2017

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Ramush Hilmi Haradinaj
2. Anita Mustafë Haradinaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani**

VENDIM

Nr. 36, datë 21.4.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Gani Dizdari	Anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	Anëtar i	“	“
Fatos Lulo	Anëtar i	“	“



me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.3.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 88/24 Akti, që u përket:

KËRKUESE: Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim, përfaqësuar në gjykim nga av. Shpëtim Beqiraj, z. Enton Mele dhe z. Artur Prenga.

Shoqata e Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun, përfaqësuar në gjykim nga av. Shpëtim Beqiraj.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar në gjykim nga avokatja e shtetit znj. Lorana Kasapi, znj. Madalena Koja dhe znj. Klodiana Marika.

Shoqata për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri, përfaqësuar në gjykim nga z. Kujtim Mersinaj.

Shoqata Shqiptare për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve, përfaqësuar në gjykim nga z. Klodian Ali.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i ligjit nr. 61, datë 2.6.2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 17, 41, 131/a dhe 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; neni 2 i Konventës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës” (Konventa e Bernës); nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fatos Lulo, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueseve, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Ministrave, Shoqatës për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri dhe Shoqatës Shqiptare për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve, të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), me propozim të Këshillit të Ministrave, ka miratuar

ligjin nr. 61/2016, datë 2.6.2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 115, datë 23.6.2016 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të saj.

2. Sipas nenit 1 të ligjit qëllimi i tij është ndalimi i ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë, me qëllim përmirësimin e gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie. Sipas nenit 3 të ligjit pezullohet përdorimi i zonave të gjuetisë, të dhëna për këtë qëllim nëpërmjet ofertës publike, kurse kontratat për mbarështimin e faunës së egër janë të vlefshme, por edhe në këto zona nuk mund të ushtrohet gjuetia. Neni 4 i ligjit ka parashikuar përjashtimet nga zbatimi i ligjit, konkretisht në rastet e konstatimit të mbipopullimit të një lloji të faunës së egër, si dhe në rastet e gjuetisë për qëllime kërkimore-shkencore, kurse në nenin 5 është parashikuar se afati i zbatimit të ligjit është 5 vjet.

3. Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim dhe Shoqata e Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën e datës 21.9.2016, duke pretenduar se ligji nr. 61/2016 është i papajtueshëm me Kushtetutën, për rrjedhojë kanë kërkuar shfuqizimin e tij.

II

4. **Kërkuesja, Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim**, në mënyrë të përmbledhur, pretendoi para Gjykatës si më poshtë vijon:

4.1 *Është cenuar parimi i sigurisë juridike.* E drejta për të ushtruar gjuetinë njihet nga jurisprudenca kushtetuese, si edhe nga Konventa e Bernës. Po kështu edhe legjislacioni ynë e ka njohur mundësinë dhe të drejtën e ushtrimit të gjuetisë. Në këtë kontekst duhet kuptuar edhe pritshmëria e gjuetarëve për ta ushtruar këtë të drejtë brenda rregullave që njihen nga ky legjislacion, i cili me ndryshimet e reja, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike, nuk ka respektuar qëndrueshmërinë e kësaj të drejte, pandryshueshmërinë e saj në substancë dhe ndryshimin e saj vetëm në mënyrë të favorshme për gjuetarët.

4.2 Parimi i sigurisë juridike u nënshtrohet kufizimeve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, federata si subjekt kërkues është e vetëdijshme se gjuetia nuk mund të ushtrohet e pakontrolluar dhe të cenojë jetesën e



faunës së egër dhe të biodiversitetit, por në përputhje me rregullat dhe kufizimet përkatëse. Megjithatë, ligji nr. 61/2016 nuk i respekton këto kërkesa, pasi cenon parimin e proporcionalitetit, është arbitrar, i padrejtë dhe si mjet legjislativ nuk është i domosdoshëm, pasi jo vetëm që nuk është mjeti më pak i dëmshëm, por qëllimi për të cilin është miratuar mund të arrihej edhe me mjete të tjera. Në fuqi janë edhe disa ligje të tjera, të cilat parashikojnë mjete ligjore për të mbrojtur zhvillimin e faunës së egër, por nuk rezultojnë nga organet administrative të jetë marrë ndonjë nga masat e parashikuara në këto akte ligjore. Në kushtet kur legjislacioni në fuqi parashikon një sërë organesh dhe mjetesh ligjore për të ndërhyrë për arritjen e qëllimit, mbrojtjen e faunës së egër, është e pakuptimtë dhe në asnjë nga relacionet e përgatitura nuk del se përse këto organe e kanë të pamundur të veprojnë nëpërmjet kompetencave që u janë dhënë dhe përse ishte i nevojshëm miratimi i një ligji të tillë për ndalimin e plotë të gjuetisë së çdo lloji dhe në gjithë territorin e vendit.

4.3 Në racionin shoqëruar është pasqyruar fakti se sipas ekspertëve të fushës disa lloje shpendësh kanë më shumë nevojë për të ripërtëritur popullatën e tyre. Edhe pse nuk del e qartë se ku bazohen këto studime dhe përse në to përmenden vetëm disa lloje kafshësh dhe shpendësh, ndalimi vendoset për të gjitha llojet e specieve. Ligji nr. 61/2016 është miratuar pas përfundimit të afatit 2-vjeçar të vendosur nga ligji nr. 7/2014. Fakti që fillimisht ishte miratuar një moratorium 2-vjeçar tregon se kafshët dhe shpendët mund të rikuperoheshin me kalimin e këtij afati. Vendosja e moratoriumeve të njëpasnjëshme dhe me afate të ndryshme tregon një lloj paqartësie për sa i takon qëllimit që kërkohet të arrihet. Pas përfundimit të afatit 2-vjeçar gjuetarët kishin pritshmëri për ushtrimin e profesionit të tyre, çka cenohet në rastin konkret.

4.4 Parimi i sigurisë juridike cenohet edhe për shkak të paqartësisë së normës. Në asnjë dispozitë të ligjit nr. 61/2016 nuk vendoset pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 10253/2010 “Për gjuetinë”, çka sjell që të kemi në fuqi dy ligje që përmbajnë parashikime të ndryshme në lidhje me të njëjtën çështje.

4.5 *Është cenuar e drejta e pronës private.* Sipas nenit 49 të ligjit nr. 10253/2010 “Për gjuetinë” personat që ushtrojnë këtë veprimtari fitojnë pronësinë mbi

gjahun që vrasin. Kjo pronësi është ushtruar në përputhje me rregullat për një kohë të gjatë, pra nuk ka qenë një e drejtë fiktive, por reale dhe e ushtruar në kohë, e cila cenohet nga ligji i kundërshtuar.

5. ***Kërkuesja, Shoqata e Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun,*** në mënyrë të përmbledhur, pretendoi para Gjykatës si më poshtë vijon:

5.1 *Është cenuar liria e veprimtarisë ekonomike.* Ligji nr.61/2016 cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë këtë liri për anëtarët e Shoqatës së Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun, pasi afati 5-vjeçar i ndalimit të gjuetisë passjell edhe ndalimin pothuajse të plotë të ushtrimit të aktivitetit ekonomik të këtyre subjekteve. Veprimtaria e tyre është e lidhur drejtpërdrejtë me ushtrimin e gjuetisë nga praktikuesit e këtij sporti, pasi sipas ligjit nr. 10253/2010 “Për gjuetinë” gjuetia është një aktivitet/sport që ushtrohet nëpërmjet përdorimit të armëve të gjahun të prodhuara për këtë qëllim. Po ashtu, edhe nga përcaktimet statutoare të shoqatës rezultojnë se ajo dhe anëtarët e saj kanë qëllim të kontribuojnë duke iu ofruar gjuetarëve mundësinë për t’u pajisur me armë gjahu. Ndërhyrja e bërë me ligjin nr. 61/2016 kufizon në mënyrë thelbësore të drejtën dhe aftësinë e anëtarëve të shoqatës kërkuese për të qarkulluar në mënyrë të lirë mallrat dhe shërbimet që ofrojnë në fushën e gjuetisë.

6. ***Subjekti i interesuar, Kuvendi,*** nuk ka paraqitur parashtrime me shkrim në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesë.

7. ***Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,*** në mënyrë të përmbledhur prapësoi para Gjykatës si më poshtë vijon:

7.1 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. Ligji i kundërshtuar nuk ka ndryshuar ndonjë dispozitë të mëparshme ligjore. Ai vetëm mundëson vijimin e një situatë të caktuar ligjore, e cila tashmë është formësuar. Si pasojë e kësaj situatë janë ndërprerë të gjitha lejet për pajisjen me armë gjahu e në të njëjtën kohë ka filluar edhe rishikimi i lejeve të dhëna. Pra, si pasojë e ligjit pararendës është krijuar një situatë faktike që e ka kthyer në normalitet mungesën e gjuetisë.

7.2 Ligji i kundërshtuar nr. 61/2016 propozon një masë drastike, por të domosdoshme dhe të nevojshme, në mënyrë që të ndalohej humbja e mëtejshme e popullatave të llojeve të faunës së



egër, si dhe të mundësohet vendosja e kontrollit mbi aktivitetin e gjuetisë, për shkak të gjendjes kritike të popullatave të faunës së egër gjatë dy dekadave të fundit, si pasojë e gjuetisë së pakontrolluar, pajisjes me armë gjahu dhe zjarri të një numri të madh personash, rritjes së numrit të gjuetarëve klandestinë në një kohë relativisht të shkurtër dhe mungesës së theksuar të kontrollit nga institucionet e ngarkuara nga ligji. Ky ligj u propozua edhe në zbatim të një sërë detyrimeve të konventave në të cilat shteti ynë është palë. Duhet theksuar se moratoriumi i parë 2-vjeçar ka dhënë efektet e tij pozitive në rigjallërimin e llojeve të faunës së egër objekt gjuetie dhe jo vetëm. Nga analiza që iu bë faunës përpara përfundimit të moratoriumit të parë, u pa e nevojshme që afati i tij të zgjatej për të mundësuar dhënien e efekteve. Ligji nr. 61/2016 garanton siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen e një pjese thelbësore të biodiversitetit dhe në mungesë të tij situata e popullatave të llojeve të faunës objekt gjuetie do të përkeqësohej deri në kërcënimin me zhdukje për to, për rrjedhojë kjo masë e ndërmarrë i përgjigjet më së miri parimit të proporcionalitetit.

7.3 Në lidhje me pretendimin se nuk janë përdorur mjetet ligjore për të mbrojtur zhvillimin e faunës së egër dhe për marrjen e masave që parashikon ligji, rezulton se Ministria e Mjedisit ka punuar intensivisht për draftimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve “Për gjuetinë”, “Për mbrojtjen e faunës së egër” dhe “Për zonat e mbrojtura”, si dhe Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimet përkatëse, sipas detyrimeve që përcaktojnë ligjet në fuqi të zbatueshme në këtë fushë. Këshilli i Ministrave ka shpallur zonat e mbrojtura, me qëllim ruajtjen e faunës së egër, ka miratuar listën e tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për Bashkimin Europian, ka përcaktuar sezonin e gjuetisë në territorin e vendit, ka miratuar listën e llojeve të faunës së egër objekt gjuetie, ka caktuar kriteret për ngritjen e rrejtës të inventarizimit dhe të monitorimit të biodiversitetit etj.

7.4 Pretendimi i Shoqatës së Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahut për cenimin e lirisë së veprimtarinë ekonomike, për shkak se në kushtet kur gjuetia është e ndaluar anëtarët e saj nuk shesin dot më armë gjahu, është i pabazuar. Aktiviteti i shitjes së armëve të gjahut është i një lloji të veçantë, i cili ushtrohet nga një numër i

caktuar personash. Për më tepër, me ligj janë caktuar kriteret shumë rigorozë për pajisjen me armë gjahu dhe pritshmëria e ligjshme për të shitur të tilla armë është zvogëluar në masë të konsiderueshme. Kërkesja nuk sjell asnjë argument ekonomik ku të provojë para Gjykatës se dëmi që vjen nga mosshitja e armëve të gjahut është i tillë që t'i mohojë çdo mundësi për vijimin normal të aktivitetit.

8. Me vendimin e datës 2.2.2017 Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës, duke e konsideruar të nevojshme për shqyrtimin e çështjes, vendosi thirrjen në gjykim, në cilësinë e subjekteve të interesuara, të ***Shoqatës për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) dhe Shoqatës Shqiptare për Mbrojtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve (SHMSHGJ)***. Këto subjekte në mënyrë të përmbledhur parashtruan para Gjykatës si më poshtë vijon:

8.1 Moratoriumi ka funksion të dyfishtë, së pari, për të përmirësuar dhe fuqizuar zbatimin e legjislacionit dhe, së dyti, për t'i dhënë një periudhë paqeje faunës së egër, e cila është gjuajtur përtej limitit të qëndrueshmërisë. Nevoja dhe domosdoshmëria e moratoriumit lidhet edhe me sigurimin e mbrojtjes tërësore për faunën e egër në përputhje me habitatin ku jeton. Referuar të dhënave për popullatat, gjykohet se periudha 2-vjeçare e moratoriumit të mëparshëm ka qenë e pamjaftueshme për rikuperimin e tyre. Madje edhe periudha 5-vjeçare e ligjit të kundërshtuar mund të lejojë vetëm një rigjenerim të pjesshëm të popullatave të llojeve me një jetëgjatësi të lartë dhe me kohë të gjatë rikuperimi. Moratoriumi i mëparshëm 2-vjeçar rezultoi i pamjaftueshëm edhe për vulosjen e armëve të deklaruara të gjuetisë, çka kërkon kohë dhe burime të konsiderueshme, që nuk ishin të disponueshme gjatë asaj periudhe. Po ashtu, kuadri ligjor në lidhje me sektorin e gjuetisë është i paplotë, për rrjedhojë i pamjaftueshëm për një kontroll të suksesshëm të gjuetisë në të gjitha fazat e saj. Një arsye tjetër për vijimësinë e kësaj nisme është se komuniteti i gjuetarëve nuk është mjaftueshëm i strukturuar dhe i organizuar për të garantuar zbatimin e një gjuetie të ligjshme, të rregulluar e të qëndrueshme. Gjithashtu, një pjesë e mirë e tyre janë teknikisht të papërgatitur për të dalluar speciet e mbrojtura nga ato objekt gjuetie.



8.2 Pretendimi i kërkueseve për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar. E drejta për gjueti, ndryshe nga sa parashtrohet, nuk është një e drejtë absolute e kategorisë së të drejtave natyrore themelore, që gëzojnë mbrojtje të drejtpërdrejtë nga Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Ajo është një e drejtë civile, e inkuadruar në gamën e të drejtave për aktivitet sportiv dhe argëtues të kohës së lirë. Një e drejtë që, sidoqoftë, për t'u ushtruar lirisht ka të nevojshme të njihet në mënyrë aktive nga shteti dhe të rregullohet nëpërmjet normave ligjore dhe nënligjore. Ligji nr. 61/2016 nuk është në thelb një mekanizëm ligjor që mohon të drejtën për gjueti, por e pezullon atë për një periudhë 5-vjeçare. Për më tepër, ligji ka parashikuar edhe raste të përjashtimit nga pezullimi/ndalimi i përkohshëm. Siguria juridike në rastin konkret krijohet dhe garantohet nëpërmjet ligjit nr. 10253/2010 “Për gjuetinë”, i cili vazhdon të jetë në fuqi. Pra, e drejta për gjueti nuk është mohuar në mënyrë përfundimtare dhe të pakthyeshme. Kërkueset asnjëherë nuk kanë qenë në kushtet e ushtrimit të gjuetisë në mënyrë të pakufizuar e të parregulluar, sepse kjo e drejtë është ushtruar gjithmonë duke përfshirë ndalime dhe kufizime të ndryshme me akte ligjore apo nënligjore.

8.3 Ligji nr. 61/2016 plotëson kriteret e nevojës, domosdoshmërisë dhe përshtatshmërisë që duhen ezauruar për të vlerësuar se parimi i proporcionalitetit nuk është cenuar. Nevoja ekziston, pasi në kuadër të zbatimit të moratoriumit të vitit 2014 janë marrë një sërë masash qoftë ligjore, qoftë strukturore dhe organizative për normalizimin e situatës, por tashmë është e qartë se nevojitet kohë më e gjatë. Kjo lloj mase e vendosur nga ligji nr. 61/2016 është e nevojshme, e domosdoshme dhe e përshtatshme, pasi interesi publik i realizuar prej saj ka shtrirjen e vetë të gjerë si në territor e popullsi, por edhe në zhvillimin ekonomik e social, madje kalon përtej interesit të një gjenerate. Kërkueset nuk kanë provuar nga ana sasiore se sa janë personat apo individët që preken nga ky ligj dhe cilat janë efektet reale të kufizimit për 5 vjet të gjuetisë, për të konkluduar në lidhje me ekuilibrimin e drejtë të interesave.

8.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së pronës private dhe të lirisë ekonomike. Në rastet kur ka pasur pretendime për ndërhyrjen e shtetit në gëzimin e qetë të pronësisë

dhe ushtrimin e lirisë ekonomike, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se mbrojtja mjedisore është një objekt legjitim i politikave publike. Nëpërmjet jurisprudencës së saj GJEDNJ-ja ka pranuar dhe njohur se mbrojtja e trashëgimisë dhe pasurisë natyrore është një qëllim legjitim që shtetet mund të ndjekin edhe kur ndërhyjnë në të drejtat individuale, veçanërisht në të drejtën e pronës private të parashikuar në nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konventës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueseve

9. Çështjen e legjitimitimit (*locus standi*) Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me iniciimin e një procesi kushtetues. Në gjykime të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës, subjektet iniciuese, që parashikohen në nenin 134/2 të Kushtetutës, kanë detyrimin për të provuar lidhjen e domosdoshme që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë ligjore që ato kryejnë dhe çështjes kushtetuese të ngritur. Në kuptimin kushtetues dhe ligjor, shoqatat paraqiten si bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, bindjeve, pikëpamjeve e interesave të përbashkët. Ato, në cilësinë e “organizatave”, janë të specifikuar në nenin 134/1/h të Kushtetutës, si një ndër subjektet që ushtrojnë në mënyrë të kushtëzuar të drejtën për t'u drejtuar Gjykatës, duke pasur legjitimitet kushtetues vetëm për çështjet që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimin nr. 78, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se vlerësimi nëse një organizatë ka ose jo interes bëhet rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çdo çështjeje të veçantë. Organizata që vë në lëvizje Gjykatën duhet të provojë se në çfarë mënyre ajo mund të preket në një aspekt të situatës së saj, pra duhet të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë dhe të individualizuar që ekziston midis situatës së saj dhe normës që kundërshton. Interesi për të vepruar duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak. Ky interes konsiston tek e drejta e shkelur, te dëmi real ose potencial dhe jo te premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kërkueset, Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim dhe Shoqata e



Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun legjitimohen *ratione personae* në kuptim të rregullimit të parashikuar nga neni 134/1/h i Kushtetutës dhe neni 49/3/d i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesja Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim (fillimisht e regjistruar me emrin Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë, ndryshuar me vendimin nr. 2277/2, datë 1.6.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë) është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 2277, datë 29.5.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kurse kërkesja Shoqata e Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 3798, datë 31.3.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rrjedhojë gëzojnë personalitet juridik në përputhje me kërkesat e ligjit.

12. Po ashtu, kërkeset legjitimohen *ratione temporis*, pasi kërkesa për shfuqizimin e normave ligjore është paraqitur brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 50/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

13. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se sipas nenit 52/2 të ligjit nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, federata përfaqëson bashkimin e shoqatave dhe mbron interesat e tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe kryen veprimtari që lidhen me trajnimin e gjuetarëve, me bashkëpunimin për ruajtjen e ekosistemeve dhe pasurimin e burimeve të gjuetisë, me mbrojtjen e mjedisit, si dhe me kultivimin e etikës së gjuetarit dhe të traditave të gjuetisë. Sipas statutit të Federatës Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim, ajo ka qëllim të sigurojë qëndrueshmërinë e burimeve të egra biologjike dhe e mbështet veprimtarinë e saj në njohjen e mjedisit global, respektimin e formave të jetës në ekosistemet e tyre, konservimin e natyrës me theksin mbi faunën, ushtrimin e gjuetisë, duke respektuar mundësitë normale të popullatave të kafshëve të egra në ekosistemet natyrore, përmirësimin dhe menaxhimin e jetës së egër dhe përdorimin racional të terreneve të gjuetisë etj. Kërkesja ka pretenduar para Gjykatës se ligji nr. 61/20016 për vendosjen e moratoriumit 5-vjeçar prek në mënyrë të drejtpërdrejtë anëtarët e saj, pasi ndalon ushtrimin e gjuetisë prej tyre, si një e drejtë

që u është njohur nga legjislacioni në fuqi, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronës private.

14. Në lidhje me kërkesen tjetër, Shoqatën e Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun, Gjykata vëren se sipas statutit dhe aktit të themelimit ajo ka për qëllim të veprimtarisë së saj ofrimin e shërbimeve dhe dhënien e kontributit për organizimin e aktiviteteve për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të anëtarëve të shoqatës, si dhe të tregtisë së ligjshme të armëve të gjahut etj. Ky subjekt ka pretenduar para Gjykatës se ligji nr. 61/2016 cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike, pasi afati 5-vjeçar i ndalimit të gjuetisë passjell edhe ndalimin pothuajse të plotë të ushtrimit të aktivitetit ekonomik të saj, i cili është i lidhur drejtpërdrejtë me ushtrimin e gjuetisë nga praktikuesit e këtij sporti. Sipas saj, ndërhyrja e bërë me ligjin nr. 61/2016 kufizon në mënyrë thelbësore të drejtën dhe aftësinë e anëtarëve të shoqatës për të qarkulluar në mënyrë të lirë mallrat dhe shërbimet që ofrojnë në fushën e gjuetisë.

15. Gjykata për sa më sipër, vlerëson se kërkeset kanë arritur të provojnë interesin e tyre të drejtpërdrejtë për t’iu drejtuar kësaj Gjykate, dhe pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, ato legjitimohen edhe *ratione materiae* për inicimin e kontrollit kushtetues të ligjit objekt kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

16. Sipas kërkeses, Federatës Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim, ligji i kundërshtuar cenon pritshmëritë e ligjshme të gjuetarëve për ta gëzuar të drejtën që u njihet legjislacioni për ushtrimin e gjuetisë brenda rregullave të përcaktuara po nga ky legjislacion. Me ndryshimet ligjore të kundërshtuara ligjvënësi nuk ka respektuar qëndrueshmërinë e kësaj të drejte, pandryshueshmërinë e saj në substancë dhe ndryshimin e saj vetëm në mënyrë të favorshme për gjuetarët. Ligji nr. 61/2016 nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, ai është arbitrar, i padrejtë dhe si mjet legjislativ nuk është i domosdoshëm, pasi jo vetëm që nuk është mjeti më pak i dëmshëm, por qëllimi për të cilin është miratuar mund të arrihej edhe me mjete të tjera. Sipas saj, në fuqi janë edhe katër ligje të tjera (nr.



8906/2002 “Për zonat e mbrojtura”, nr. 9587/2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, nr. 10006/2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” dhe nr. 10253/2010 “Për gjuetinë”), të cilat parashikojnë mjete ligjore për të mbrojtur zhvillimin e faunës së egër, por nuk rezultojnë që nga organet administrative të jetë marrë ndonjë nga masat e parashikuara në këto akte ligjore. Në kushtet kur legjislacioni në fuqi parashikon një sërë organesh dhe mjete ligjore për të ndërhyrë për arritjen e qëllimit, mbrojtjen e faunës së egër, nuk rezultojnë se përse këto organe e kanë të pamundur të veprojnë nëpërmjet kompetencave që u janë dhënë dhe përse ishte i nevojshëm miratimi i një ligji të tillë për ndalimin e plotë të gjuetisë së çdo lloji dhe në të gjithë territorin e vendit. Vendosja e moratoriumeve të njëpasnjëshme dhe me afate të ndryshme tregon një lloj paqartësie për sa i takon qëllimit që kërkohet të arrihet. Sipas kërkueses, parimi i sigurisë juridike cenohet edhe për shkak të paqartësisë së normës. Në asnjë dispozitë të ligjit nr. 61/2016 nuk vendoset pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 10253/2010 “Për gjuetinë”, çka sjell që të kemi në fuqi dy ligje që përmbajnë parashikime të ndryshme në lidhje me të njëjtën çështje.

17. Sipas subjektit të interesuar, Këshilli të Ministrave, ky pretendim është i pabazuar, pasi ligji i kundërshtuar nuk ka ndryshuar ndonjë dispozitë të mëparshme ligjore, por ai mundëson vetëm vijimin e një situatë të caktuar ligjore, e cila tashmë është formësuar. Si pasojë e ligjit pararendës është krijuar një situatë faktike që e ka kthyer në normalitet mungesën e gjuetisë. Kurse sipas subjekteve të interesuara, PPNEA-së dhe SHMSHGJ-së, e drejta për gjueti nuk është një e drejtë absolute e kategorisë së të drejtave natyrore themelore, që gëzojnë mbrojtje të drejtpërdrejtë nga Kushtetuta dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Ajo është një e drejtë civile, e inkuadruar në gamën e të drejtave për aktivitet sportiv dhe argëtues të kohës së lirë. Sipas këtyre subjekteve, ligji nr. 61/2016 nuk është në thelb një mekanizëm ligjor që mohon të drejtën për gjueti, por e pezullon atë për një periudhë 5-vjeçare dhe kjo masë e vendosur nga ligjvënësi është e nevojshme, e domosdoshme dhe e përshtatshme.

18. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca

kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situatë të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar në Kushtetutë dhe shoqërimi me masat për vënien e tyre në jetë duhet të synojnë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave (*shih vendimin nr. 37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Ligji duhet të ofrojë siguri dhe vijimësi, me qëllim që individët të mund të kryejnë veprimet në mënyrën e duhur. Duke qenë se këto ligje e vendime perceptohen si burime pritshmërie të ligjshme për individët, ato nuk mund të ndryshohen e shfuqizohen në një fazë të mëvonshme. Ky parim u lejon individëve një lloj mbrojtjeje kundër ndryshimeve të menjëhershme e të pajustificueshme të rregullave. Nxjerrja e normave juridike nuk i shërben vetëm zgjidhjes së një konflikti të mundshëm apo rregullimit të një situatë të parregulluar më parë. Ky proces duhet të krijojë përshtypjen te subjektet e së drejtës se përmbajtja e normave juridike garanton siguri dhe qëndrueshmëri për të ardhmen. Siguria juridike trajtohet edhe si kusht për vlefshmërinë materiale të një akti, duke garantuar pandryshueshmërinë në parim të akteve normative, ku i kushtohet vëmendje rregullimit të situatave pa ndryshime substanciale në vazhdimësi, pasi në të kundërt do t'i vendosnim subjektet e së drejtës në pozicione të papëlqyeshme dhe të pafavorshme për to. Përmbledhtazi, ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht, mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasojat pozitive - konkretisht, trajtim më të mirë (financiar ose jo) - për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve ligjore e përkeqëson situatën,



pra kur u heq subjekteve përfutuese një të drejtë të fituar më parë. Megjithatë, kjo Gjykatë ka theksuar se parimi i sigurisë juridike nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor i ndryshëm i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes natyrshëm do të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike (*shih vendimin nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata rithekson se e drejta e ligjvënësimit për të rregulluar një situatë ndryshe nga ajo ekzistuese duhet të mbetet në thelb e paprekur, si një nga kërkesat e një shoqërie në zhvillim të vazhdueshëm, e cila nuk mund të kuptohet pa një kuadër normativ dinamik që i përshtatet zhvillimit të saj (*shih vendimin nr. 10, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, vetëm fakti i ndryshimit të një situatë ligjore dhe fakti i ardhjes së pasojave për subjektet ndaj të cilave zbatohet kuadri i ri ligjor nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve ajo nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar duhet të parashtrohen argumente bindëse për t'i dhënë mundësi Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të aplikuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese. Gjykata çmon se Kuvendi, si organ ligjvënës, ka të drejtë të zbatojë apo konkretizojë politika të caktuara për përmirësimin e qeverisjes dhe zhvillimin e vendit në tërësi, si dhe t'u përgjigjet prioriteteve ose problemeve të ndryshme të vendit. Megjithatë, duhet të ritheksohet se ligjet apo dispozitat të veçanta të tyre, të miratuara nga ligjvënësi për këtë qëllim, nuk duhet të vijnë në kundërshtim me dispozitat e Kushtetutës (*shih vendimin nr. 29, datë 31.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në praktikën kushtetuese është pranuar tashmë se ligjvënësi, parimisht, është i lirë të veprojë brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë. Parimi i shtetit social, i parashikuar që në preambulën e Kushtetutës sonë, e përligj ndërhyrjen e autoritetit publik në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë edhe në marrëdhëniet juridike private për të mbrojtur interesat e përgjithshëm, siç janë kontrolli publik i

koshtos së jetesës, lufta kundër inflacionit, shtytja dhe nxitja e aktiviteteve prodhuese, mbrojtja e shtresave të varfra, promovimi i vlerave sociale, etj. (*shih vendimin nr. 52, datë 5.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Masat e ligjvënësimit mund të jenë të shumëllojshme, madje edhe të karakterit monetar, por ajo që ka rëndësi në këtë rast është që thelbi i së drejtës të individit të mos cenohet deri në atë masë sa të bëhet i pamundur ushtrimi i saj (*shih vendimin nr. 10, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata për të përcaktuar natyrën dhe thelbin e së drejtës që pretendohet të jetë cenuar e sheh me vend t'i referohet ligjit nr. 10253, datë 11.3.2010 "Për gjuetinë", i cili në nenin 1 e përcakton gjuetinë si një veprimtari tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike. Në këtë kuptim, sipas Gjykatës, nuk bëhet fjalë për një veprimtari me natyrë kushtetuese, cenimi i së cilës sjell kufizimin e një të drejte themelore kushtetuese, por për një veprimtari me natyrë sociale. Sipas nenit 59 të Kushtetutës shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon, mes të tjerash, edhe zhvillimin e sportit dhe të veprimtarive ripërtëritëse (pika 1, shkronja "ë"). Sipas pikës 2 të këtij neni përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohej drejtpërdrejt në gjykatë, dhe është ligji që përcakton kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohej realizimi i këtyre objektivave. Në kuadrin e përpjekjeve për të përmbushur objektivat sociale, është e drejtë legjitime e vetë shtetit rregullimi i sistemit të mbrojtjes sociale, duke hartuar dhe zbatuar politikat dhe strategjitë sociale. Ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave, duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese. Kushtet dhe masa në të cilat mund të kërkohej realizimi i objektivave sociale i përket rezervës ligjore absolute, pra rregullimit me ligj të miratuar nga ligjvënësi (*shih vendimet nr. 34, datë 28.5.2012; nr. 1, datë 6.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata ka vlerësuar se të drejtat sociale dallojnë nga objektivat sociale, pasi këta të fundit janë shprehje e qëllimeve të shtetit dhe parimeve të politikave të hartuara prej tij për orientimin e veprimtarisë në përgjithësi dhe, veçanërisht, të politikave sociale. Objektivat sociale janë shprehje e



veprimet pozitiv të shtetit dhe, për rrjedhojë, realizimi i tyre është ngushtësisht i lidhur me kushtet, mjetet dhe mundësitë e disponueshme buxhetore të shtetit. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar, gjithashtu, se përmbushja e objektivave sociale nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetues (*shih vendimet nr. 10, datë 18.3.2013; nr. 14, datë 17.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata vëren se ndonëse kërkesja ka pretenduar se ndërhyrja e ligjvënësimit me miratimin e ligjit të kundërshtuar nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, ajo nuk ka arritur të provojë se cila është e drejta/liria kushtetuese që kufizohet/cenohet në rastin konkret. Në seancë plenare kërkesja kundërshtoi pretendimin e subjektit të interesuar për karakterin sportiv të kësaj veprimtarie, por ajo nuk arriti të paraqesë argumente për të provuar të kundërtën. Kërkesja nuk arriti të provojë se kjo veprimtari lidhet në mënyrë të pashmangshme me të drejtat kushtetuese me karakter ekonomik, social apo kulturor. Ajo nuk arriti të provojë se për shkak të mënyrës se si ushtrohet gjuetia, traditave dhe kulturës që ka zhvilluar, përfaqëson një pjesë kaq të qenësishme të jetesës dhe identitetit të anëtarëve të saj, sa të sjellë impakt në jetën private dhe familjare të këtyre subjekteve. Po ashtu, kërkesja nuk arriti të provojë se kjo veprimtari ka karakter ekonomik dhe gjeneron të ardhura, por as impaktin dhe pasojat që ajo sjell për personat që e ushtrojnë në bazë të lejeve përkatëse. Përkundrazi, në seancë plenare përfaqësuesit e kërkesës parashtruan se kjo veprimtari nuk ushtrohet për qëllime fitimprurëse dhe se nuk ekziston asnjë mundësi që një biznes të mbahet duke tregtuar lëndën e parë që është gjahu i egër. Sipas saj, e vetmja veprimtari tregtare janë fermat e gjuetisë, të cilat furnizojnë habitatet e gjuetisë, kryesisht me shpendë endemikë, por edhe në këtë drejtim kërkesja nuk arriti të argumentojë se cilat janë pasojat ekonomike që u kanë ardhur subjekteve që e ushtrojnë këtë veprimtari specifike me karakter ekonomik dhe në çfarë mase preken ato nga kufizimi i vendosur me ligjin nr. 61/2016.

25. Sipas nenit 59/1 të Kushtetutës shteti synon edhe garantimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm (shkronja “d”), shfrytëzimin

racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm (shkronja “dh”) dhe mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare e kulturore (shkronja “g”). Sipas nenit 1/b të ligjit nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, fauna e egër vlerësohet si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj. Edhe sipas nenit 2 të ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, fauna e egër në territorin e Republikës së Shqipërisë është pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj, në përputhje edhe me konventat ndërkombëtare, ku shteti ynë është palë. Konventa e Bernës “Për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës” e datës 19 shtator 1979, ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr. 8294, datë 2.3.1998, ka për objekt të saj ruajtjen e florës, të faunës së egër dhe vendbanimet e tyre natyrale (neni 1). Sipas nenit 3 të Konventës, çdo palë kontraktuese merr masat e nevojshme për të vënë në jetë një politikë kombëtare për ruajtjen e florës, të faunës së egër dhe të vendbanimeve natyrale, duke u kushtuar kujdes të veçantë specieve në rrezik zhdukjeje dhe atyre të dëmtuara, sidomos specieve endemike dhe vendbanimeve të kërcënuara. Përveç akteve të mësipërme ligjore, bazuar në parashtrimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, rezulton që në zbatim të tyre të jenë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore, me qëllim respektimin e detyrimeve për mbrojtjen e llojeve të faunës së egër objekt gjuetie, konkretisht për shpalljen e disa zonave park natyror, miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, krijimin dhe funksionimin e qendrave të shpëtimit të llojeve të faunës së egër, përcaktimin e sezonit të gjuetisë, inventarizimin e llojeve të faunës së egër objekt gjuetie etj.

26. Gjykata vëren se pas përfundimit të moratoriumit të mëparshëm të gjuetisë për një afat 2-vjeçar (2014 – 2016), me ligjin nr. 61/2016 ai është zgjatuar edhe për një afat tjetër 5-vjeçar. Sipas subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, vendosja e moratoriumit është ndërmarrë në kushtet e një gjendjeje tejet të rënduar për natyrën dhe biodiversitetin në përgjithësi, dhe të faunës së egër objekt gjuetie në veçanti. Synimi i vendosjes së moratoriumit është ndalimi i humbjes së mëtejshme të popullatave të llojeve të faunës së egër që ishin në një minimum kritik, si dhe krijimi i kushteve normale të jetës së egër. Sipas këtij subjekti, ligji i kundërshtuar propozon një masë



drastike, por të domosdoshme dhe të nevojshme, në mënyrë që të ndalohet humbja e mëtejshme e popullatave të llojeve të faunës së egër, si dhe të mundësohet vendosja e kontrollit mbi aktivitetin e gjuetisë, për shkak të gjendjes së rënduar kritike të popullatave të faunës së egër gjatë dy dekadave të fundit, si pasojë e gjuetisë së pakontrolluar, pajisjes me armë gjahu dhe zjarri të një numri të madh personash, rritjes së numrit të gjuetarëve klandestinë në një kohë relativisht të shkurtër dhe mungesës së theksuar të kontrollit nga institucionet e ngarkuara nga ligji. Në kushtet kur moratoriumi i parë 2-vjeçar dha efektet e tij pozitive në rigjallërimin e llojeve të faunës së egër objekt gjuetie dhe jo vetëm, u pa e nevojshme që afati i tij të zgjatej edhe për një periudhë 5-vjeçare. Kurse sipas relacionit për projektligjin për moratoriumin e gjuetisë, periudha e moratoriumit të mëparshëm ka krijuar premisat edhe për qetësinë e nevojshme për rimëkëmbjen e popullatave të faunës së egër objekt gjuetie.

27. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesja nuk ka arritur t'i ngrejë këto pretendime në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë se cila e drejtë apo liri kushtetuese është cenuar nga moratoriumi i miratuar me ligjin nr. 61/2016 dhe pasojat që kanë ardhur nga ky kufizim. Gjykata vlerëson se në rastin konkret përballen mes tyre objektivat sociale që shteti i garanton brenda mjeteve që disponon. Sipas akteve ligjore që kanë rregulluar ndër vite ushtrimin e gjuetisë, fauna e egër konsiderohet si pasuri kombëtare dhe ajo mbrohet nga shteti me ligj. Qëllimi i miratimit të rregullave konkretë dhe specifikë për ushtrimin e gjuetisë është pikërisht mbrojtja e kësaj pasurie, në mënyrë që ajo të mos zhduket apo të dëmtohet. Për sa kohë që shteti nuk ka mjetet e nevojshme për menaxhimin e kësaj veprimtarie, është në vlerësimin e tij ndërmarrja e masave të tilla, me qëllim përmirësimin e situatës dhe garantimin e objektivave të tjerë sociale, siç janë shfrytëzimi racional i burimeve natyrore apo edhe mbrojtja e trashëgimisë natyrore të vendit. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe proporcionalitetit të ndërhyrjes në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës është i pazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së pronës private

28. Kërkesja Federata Kombëtare Shqiptare për Gjueti dhe Konservim pretendon se ligji

nr.61/2016 cenon të drejtën e pronës private, pasi sipas nenit 49 të ligjit nr. 10253/2010 “Për gjuetinë”, personat që ushtrojnë profesionin e gjuetarit fitojnë pronësinë mbi gjahun që vrasin. Duke qenë se kjo pronësi është ushtruar në përputhje me rregullat për një kohë të gjatë, ajo nuk ka qenë një e drejtë fiktive, por reale dhe e ushtruar në kohë, që cenohet nga ligji i kundërshtuar.

29. Gjykata vëren se garantimi i së drejtës së pronës përbën një ndër aspektet më thelbësore të shoqërisë demokratike. Sipas nenit 41 të Kushtetutës e drejta e pronës private është e garantuar dhe askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik. Gjykata thekson se e drejta e pronës, si e drejtë universale e njeriut, përfshin çdo posedim të sendeve ose të drejtave të tjera materiale pasurore. Në një shtet demokratik, individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i së drejtës së pronës. E drejta e pronës në çdo rast shtrihet ndaj sendeve pronësie e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se me gjithë mbrojtjen që ajo gëzon, e drejta e pronës mund t'u nënshtrohet kufizimeve, por këto kufizime duhen bërë sipas disa kritereve të përcaktuara në mënyrë shteruese në nenin 17 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 25, datë 28. 4.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata ka theksuar se koncepti i së drejtës së pronës është mjaft i gjerë dhe shtrihet si ndaj sendeve të paluajtshme, ashtu edhe ndaj atyre të luajtshme. Ky koncept mbulon edhe një hapësirë të madhe interesash ekonomikë. Neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së përmban tri rregulla mbi bazë të të cilave bëhet kontrolli nëse kemi të bëjmë me cenim të së drejtës së pronës në kundërshtim me këtë dispozitë. Kështu, rregulli i parë lidhet me gëzimin e lirë të pronës në paqe, rregulli i dytë lidhet me kufizimin e së drejtës së pronësisë sipas kushteve të caktuara, kurse rregulli i tretë u njeh shteteve të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, duke vënë në zbatim ligje që i gjuetojnë të nevojshme për këtë qëllim. Të tria këto rregulla i përgjigjen të njëjtut qëllim: garantimin e pronarit nga ndërhyrje të tilla të shtetit që mund të arrijnë deri në atë pikë sa të rrezikojnë ekzistencën e veprimtarisë fitim-prurëse që ai ushtron (*shih vendimin nr. 10, datë 19.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).



31. Sipas nenit 48 të ligjit nr. 10253, datë 11.3.2010 “Për gjuetinë”, në përfundim të ditës së gjuetisë gjuetari deklaron te menaxhuesi i zonës numrin e kafshëve e të shpendëve të vrara, duke i treguar ato, ai likuidon në vend pagesën për secilën dhe merr mandat-pagesën përkatëse. Sipas nenit 49 të po këtij ligji gjahu i vrarë gjatë ushtrimit të gjuetisë i përket personit që e ka vrarë atë. Bazuar në këto dispozita fauna e egër objekt i gjuetisë nuk është në pronësi të gjuetarit, por bëhet e tij vetëm në kushtet e parashikuara në ligji. Për rrjedhojë, një pretendim i tillë se hipotetikusht gjuetari, nëse nuk do të ndalohej ushtrimi i kësaj veprimtarie, do të kishte të drejtën të mbante gjahun e vrarë, është i pabazuar nga pikëpamja kushtetuese. Për sa kohë që në rastin konkret nuk ndodhemi para cenimit real dhe jo të supozuar të një të drejte pronësie të këtyre subjekteve, ky pretendim është haptazi i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të lirisë së veprimtarisë ekonomike

32. Sipas kërkuases, Shoqatës së Tregtarëve të Armëve dhe Materialeve të Gjahun, ligji nr. 61/2016 cenon lirinë e veprimtarisë ekonomike, pasi për afatin 5-vjeçar të ndalimit të gjuetisë passjell edhe ndalimin pothuajse të plotë të ushtrimit të aktivitetit ekonomik të saj, i cili është i lidhur drejtpërdrejtë me ushtrimin e gjuetisë nga praktikuesit e këtij sporti. Ndërhyrja e bërë me ligjin nr. 61/2016 kufizon në mënyrë thelbësore të drejtën dhe aftësinë e anëtarëve të shoqatës për të qarkulluar në mënyrë të lirë mallrat dhe shërbimet që ofrojnë në fushën e gjuetisë.

33. Sipas nenit 11/1 të Kushtetutës sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike. Gjykata ka vlerësuar se liria e veprimtarisë ekonomike, nënkupton, kryesisht, të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individ, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe shërbimeve, por forma më e lartë e saj nënkupton të drejtën e pronës, lirinë pa asnjë kufizim të qarkullimit të fuqisë punëtore, të kapitalit dhe të mallrave. Po ashtu, liria e veprimtarisë ekonomike përmban në vetvete

edhe lirinë e biznesit ose aftësinë për të krijuar dhe mbyllur një sipërmarrje, lirinë e tregtisë ose mungesën e barrierave lidhur me importimin dhe eksportimin e mallrave dhe shërbimeve, lirinë monetare si masë për të garantuar qëndrueshmëri të çmimit, lirinë fiskale mbi të ardhurat qoftë individuale, qoftë ndaj biznesit në mënyrë të veçantë, të drejtat e pronës si aftësi e individëve për të grumbulluar, poseduar dhe disponuar sende, të lirë nga ndërhyrja e shtetit, lirinë e investimit dhe qarkullimit të lirë të kapitaleve, veçanërisht kapitalit të huaj, lirinë financiare dhe pavarësinë nga kontrolli shtetëror, lirinë e punës për të ndërvepruar pa kufizime nga shteti (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Liria e veprimtarisë ekonomike përmban edhe detyrimin e shtetit që nëpërmjet ligjvënësit të ndërhyjë në rregullimin e saj, me qëllim që të garantohet edhe parimi i shtetit social dhe i së mirës së përbashkët. Ky detyrim për rregullim i ligjvënësit shprehet nëpërmjet nxjerrjes së normave konkrete juridike, me anë të së cilave synohet disiplinimi i ushtrimit të veprimtarisë së lirë ekonomike në sektorë apo fusha të caktuara. Në këtë rast, shteti duhet të luajë rolin e katalizatorit për realizimin efektiv të lirisë ekonomike, nga njëra anë, dhe mbrojtjes së kësaj lirie, nga ana tjetër. Vetëm shteti mund të arrijë të krijojë mjedisin e vërtetë dhe optimal për ushtrimin e kësaj lirie vetjake, prandaj ai duhet parë si rregullator me qëllim mbrojtjen e tregut nga deformimet që natyrshëm mund t'i mbartë me vete zhvillimi i lirë i veprimtarisë ekonomike (*shih vendimin nr. 33, datë 8.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Gjykata vëren se ligji nr. 61/2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë” ka vendosur ndalimin e ushtrimit të aktivitetit të gjuetisë, por ai nuk ka parashikuar asnjë kufizim në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike të subjekteve tregtare që merren me armët dhe materialet e gjuetisë. Kërkuësja nuk ka arritur të argumentojë se cili është dëmi real dhe i drejtpërdrejtë që sjell ky ligj në veprimtarinë tregtare të anëtarëve të saj, pra se në ç'mënyrë dhe në ç'masë preken ata nga këto rregullime ligjore. Po ashtu, bazuar në ekstraktet e regjistrit tregtar, bashkëlidhur materialeve shoqëruese të kërkesës, të disa shoqërive anëtare të kësaj shoqate, rezulton se tregtimi i armëve dhe materialeve të gjuetisë është vetëm një nga objektet e veprimtarisë së këtyre subjekteve, e cila rezulton



të përfshijë edhe fusha të tjera jashtë dhe tej këtij objekti. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuases për cenimin e lirisë së veprimtarisë ekonomike janë haptazi të pabazuara.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e ngritura në kërkesë janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.¹

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/1/a dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të neneve 49, 51, 51/a, 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Gani Dizdari

KËRKESË

Shtetësja Eda Bruzja, lindur në Tiranë më 25.11.1958, kërkon shpalljen të zhdukur të vëllait të saj shtetasit Fatmir Bruzja, lindur në Vlorë më 31.8.1968.

KËRKUESE
Eda Bruzja

KËRKESË

Shtetasi Zyhdi Boka, lindur në Tiranë më 13.4.1963, kërkon shpalljen të vdekur të motrës së tij shtetases Lumturi Boka.

KËRKUESI
Zyhdi Boka

¹ Gjyqtarët V. Tusha dhe G. Dizdari u shprehën për pranimin e kërkesës për shfuqizimin vetëm të nenit 5 të ligjit nr. 61, datë 2.6.2016 “Për shpalljen e moratoriumit të gjuetisë në Republikën e Shqipërisë”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë